



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.a
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Tel: 038 544 551, 544 552
Adresa: Rexhep Krasniqi p.n, Lagjia Emshir
Prishtinë, Republika e Kosovës

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

Nr. 06/2013

Datë: 22/10/2013

Në bazë të nenit 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, në bazë të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pas diskutimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22/10/2013, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A mori këtë :

VENDIM

1. Miratohet Plani i Biznesit të KMDK SH.A për periudhën 2014-2016.
2. Autorizohet Menaxhmenti që të bëjë plotësimet dhe ndryshimet e dhëna gjatë diskutimeve në mbledhjen e BtD.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të KMDK-së
2. Anëtarëve të Bordit
3. NJPMNP/MZHE

Asllan Vitaku

Kryesues i BtD të KMDK SH.A

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Çeverit e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development		KMDK SH.A		Dalëse <input checked="" type="checkbox"/> Hyrëse <input type="checkbox"/>
Nr. / Foljeve Broj / Stranica No. / pages	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. / Foljeve Broj / Stranica No. / pages	Nr.	Data
✓	2137	✓	1018/13	30.10.13
PRISHTINE/A		KMDK		

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË

PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2014-2016

Tetor 2013

Përmbajtja.....	2
Shkurtesat.....	3
1. Historiku i Kompanisë	4
1.1. Historiku i Kompanisë.....	4
1.2. Deklarata politikës.....	5
1.3 Misioni.....	5
1.4. Deklarata e riskut.....	5
1.5. Deklarata e tarifave të shërbimit.....	5
1.6 Qëllimi	6
2. Vlerësimi i performances së kaluar.....	6
2.1. Operativa.....	6
2.2. Financat.....	7
2.3. Struktura organizative dhe burimet njerëzore.....	7
3. Plani operativ.....	7
3.1. Potenciali për rritjen e biznesit.....	7
3.2. Aktivitetet primare dhe sekondare të biznesit të Kompanisë.....	7
4. Plani i analizave financiare	8
Plani i analizave financiare Anex I.....	9
4.1. Deklarata dhe analiza e të hyrave	10
4.2. Analiza e shpenzimeve.....	11
5. Plani i zhvillimit të personelit.....	11
5.1. Struktura e re organizative.....	11
5.2. Trajnimet e personelit.....	11
5.3. Politika e pagesës së personelit.....	12
5.4. Organogrami.....	13
6. Plani i investimeve	14
6.1 Plani i investimeve për 2014	15
6.2 Projektet e synuara gjatë periudhës 2014-2016.....	15
6.2. Plani i investimeve për 2015	16
6.3 Plani i investimeve për 2016.....	17
7. Sfidat dhe Rreziqet nga Plani i Biznesit.....	18

Shkurtesat

LNP	Ligji për Ndërmarrje Publike
LM.....	Ligji për Mbeturina
KMDK.....	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
NJPMNP.....	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
MTI.....	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
ZRRUM.....	Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina
MMPH.....	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
BD.....	Bordi i Drejtorëve
KA.....	Komiteti i Auditimit
KPSDS.....	Komiteti për përafrimin e standardeve në Deponitë Sanitare
KE.....	Kryeshefi Ekzekutiv
KRM.....	Kompanitë Regjionale të Mbeturinave
PB	Plani i Biznesit
DS.....	Deponite Sanitare
AER.....	Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Përmbledhje Ekzekutive

Ky Plan i Biznesit është dokument themelorë i zhvillimit të kompanisë për vitin 2014 -2016, i cili definon qartë misionin, synimet dhe rezultatet e pritshme, duke bërë krahasime me të arriturat e periudhës së kaluar.

Plani i Biznesit është përgatitur nga grupi punues i cili është bazuar në gjendjen ekzistuese dhe misionin e zhvillimit të kompanisë në trajtimin e mbeturinave dhe hedhurinave sipas standardeve dhe praktikave evropiane. Ky plan ka marrë parasysh edhe infrastrukturën ligjore që ndërlidhen me menaxhimin e sektorit të mbeturinave në nivelin qendrorë dhe komunal.

Me qëllim të përkrahjes afariste të kompanisë në menaxhimin e biznesit, në ruajtjen, sigurinë, integritetin dhe administrimin sa më efikas të të dhënave, kompania do të zhvillojë një sistem qëndrueshëm të teknologjisë informative.

Realizimi i Planit të Biznesit përveç që është bazuar nga të hyrat vetanake është i orientuar edhe në mbështetjen që do të ketë prej Institucioneve financiare qeveritare apo Donatorëve.

Plani i biznesit ka për qëllim menaxhimin e mirëfilltë me mbeturinat komunale që deponohen në deponitë sanitare të KMDK-së.

Ky plan i biznesit do t'i nënshtrohet rishikimit dhe azhurnimit në bazë vjetore nëse është e nevojshme dhe miratohet nga Bordi i Drejtorëve.

Historiku i Kompanisë

1.1. Historiku

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e legalizuar dhe e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare. Struktura institucionale, roli dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante në menaxhimin e DS të mbeturinave në Kosovë janë përcaktuar me legjislacionin që është në fuqi, në bazë të cilit është emëruar Bordi i Drejtorëve nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (NR. 03/L-087) përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim, mbikëqyrë afarizmin e ndërmarrjeve publike të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe përkujdeset për monitorimin dhe transparencën e tyre. Ky ligj themelon kornizën për ushtrimin e të drejtës pronësore në ndërmarrjet publike dhe rregullon qeverisjen e korporatave të këtyre ndërmarrjeve.

Kompania është themeluar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, donacion i dhënë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (AER). KMDK menaxhon me këto asete konform legjislacionin në fuqi dhe standardeve të e përcaktuara me qëllim të ruajtjes së mjedisit dhe rritjes së vlerës së aseteve të kompanisë.

Kompania ofron shërbimet e veta në këto Deponi regjionale:

Deponia Sanitare e Mirashit - Prishtinë
Deponia Sanitare e Dumnicës - Podujevë
Deponia Sanitare e Landovicës - Prizren
Deponia Sanitare e Velekincës - Gjilan
Stacionin e Transferit në Ferizaj

1.2. Deklarata e politikës

Kompania do të siguroj shërbime të sigurta, të besueshme dhe mirë të organizuara në të gjitha DS, njëkohësisht duke siguruar një qëndrueshmëri financiare.

Qasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe etike, e bazuar në legjislacionin në fuqi.

Kjo do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Njësisë Monitoruese për Ndërmarrjet Publike, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor dhe akterët tjerë.

1.3. Misioni dhe vizioni

Misioni:

Misioni i kompanisë është menaxhimi i mbeturinave që vijnë në deponitë sanitare të KMDK-së, Evitimi i rreziqeve që mund të vijnë gjatë trajtimit të mbeturinave dhe parandalimi i ndotjes së mjedisit.

Vizioni:

Operimi dhe trajtimi i mbeturinave më qëllim të ruajtjes së ambientit, rritja e vlerës së aseteve dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi i së tashmes dhe i së ardhmes së kompanisë.

1.4. Deklarata e riskut

Përgatitja e këtij Plan Biznesi është bërë duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë së aktiviteteve biznesore në një periudhë të gjatë kohore.

Rreziqet e mundshme në aspektin e parashikimit për periudhën në të cilën bëhet ky plan biznesi dhe pamundësia e realizimit të tij mund të përmbledhet në:

Mos arkëtimi i llogarive të arkëtueshme

Mos aprovimi i ngritjes së tarifës së shërbimit (në shkallë të kërkuar),

Fillimi i procesit të ndarjes apo riciklimit të mbeturinave nëpër Komuna,

Forcat tjera madhore (tërmeti, vërshimet, zjarret etj.)

1.5. Deklarata e tarifave të shërbimeve

KMDK do të zbatoj tarifën e përcaktuar nga MZHE dhe akteret tjerë sipas legjislacionit në fuqi. (Ligjit të mbeturinave dhe udhëzimit për menaxhimin e deponive të mbeturinave)

Tarifa aktuale e përcaktuar nga ZRRUM 5.31 € + TVSH ka qenë për një periudhë fikse nga 01.06.2012 deri me 31.05.2013, konsiderojmë se nuk kanë qenë reale. Prandaj kemi bërë kërkesën për ngritjen e tarifave pranë MZHE-së si autoritet kompetent për përcaktimin e tarifave.

Për mbulimin e kostos së trajtimit të mbeturinave Kompania ka planifikuar në vitet vijuese ngritjen e tarifës prej 5.31 në 9.86 në DS dhe në 13.36 në STF.

Aprovimi i tarifave të reja do të mundësoj mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale dhe qëndrueshmërisë financiare në KMDK. SH.A.

1.6 Qëllimi

Qëllimi kryesor i KMDK SH.A që nga themelimi është menaxhimi i mbeturinave në DS sipas standardeve.

Qëllimi i kompanisë mund të arrihet nëpërmjet të:

- Ngritjes së inkasimit dhe arkëtimit të borxheve nga KRM-të dhe subjekteve private . Ngritja e inkasimit do të mundësonte qëndrueshmëri të KMDK-së, përmirësimin e gjendjes teknike dhe infrastrukture të DS, shlyerjen e borxheve dhe obligimeve ndaj furnitorëve.
- Riparimi dhe mirëmbajtja e makinerisë , mirëmbajtje dhe rregullim te infrastrukturës në të gjitha DS, krijimin e kushteve më të mira për klientët e KMDK dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit.
- Rivendosja e sistemit të ajrosjes në të gjitha DS sipas standardeve.
- Vendosja e peshoreve digjitale dhe kamerave, si dhe monitorimi i tyre nga selia e kompanisë.
- Trajnimi - avancimi profesional i stafit të KMDK-së,

2. Vlerësimi i performancës së kaluar

Gjatë viteve paraprake kompania ka përbushur detyrat e saj në përputhje me Planet e Biznesit duke zvogëluar shpenzimet dhe rritur të hyrat çka ka rezultuar me një bilanc pozitiv për ndërmarrjen,detyra të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga Bordi i Drejtorëve.

2.1. Operativa

Gjatë vitit 2013 numri i klientëve të kontraktuar për zbrazje në Deponitë Sanitare është 30 klientë, prej tyre 5 Kompani Regjionale të Mbeturinave dhe 25 klientë privat.

Vëllimi i përgjithshëm i mbeturinave i shprehur në tonelatë është 151 460 ton/mbeturinë për nëntë mujorin e 2013.

Sipas planeve ditore operative kompania ka përbushur dhe plotësuar kushtet e nevojshme për të gjithë klientët në shtyrjen dhe rrafshimin e mbeturinave si dhe në kompaktimin dhe mbulimin e mbeturinave sipas standardeve.

Në vazhdimësi kompania ka investuar dhe vazhdon të investoj në krijimin e kushteve tjera edhe më të mira jo vetëm për klientët por edhe me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit si:

- Investime në infrastrukturë
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve
- Hapja e kanaleve për mbrojtjen e DS nga ujërat atmosferike
- Siguria dhe evitimi nga rreziqet dhe zjarret
- Mbyllja e sektorëve ekzistues dhe hapja e sektorëve të ri për mbeturina brenda DS sipas standardeve
- Kujdes i veçantë me qëllim të ruajtjes së mjedisit Kompania i ka kushtuar kontrollit të vazhdueshëm ujërave të zeza, në DS Landovicë është ndërtuar laguna e re ndërsa në DS Mirash

gjendja e ujërave të zeza është shqetësim që nga ndërtimi i Deponisë i ngritur ndër vite, shqetësim i drejtuar BD, Aksionarit dhe aktereve tjerë.

2.2. Financat

KMDK gjatë vitit 2013 - 9 mujorit ka rezultuar, realizim të biznesit si në vijim:

- Te hyrat nga planifikimi me Planin e Biznesit për 9 mujorin e 2013 ka qenë 97.5 %,
- Shkalla e inkasimit gjatë 9 mujorit ka qenë 80%,
- Shkalla e punës (mbledhja e të hyrave operative /mbledhja e kostove operative) në vitin 2013 ishte 0.76 .
- Shkalla e mbulesës së punës (të ardhurat operative /mbledhja e kostove operative) në vitin 2013 ishte 0.93.
- Në vitin 2013 mesatarja totale e kostove operative për tonelatë të hedhur ishte 9.53 €/ton.

2.3. Struktura organizative dhe burimet njerëzore

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087, KMDK SH.A, udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili i përgjigjet drejtpërsëdrejti Bordit të Drejtorëve. Me qëllim të menaxhimit më eficient dhe efektiv, BtD ka aprovuar strukturën organizative të ndërmarrjes dhe rregulloret e brendshme në bazë të cilave kjo strukturë përbëhet prej dy Drejtorive, të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes menaxhmentit të Kompanisë. Drejtoritë përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes të menaxhmentit të Kompanisë janë: Drejtoria e Operatives dhe Drejtoria e Administratës.

Me zgjerimin e veprimtarisë, Kompania planifikon të rris numrin e punëtorëve sipas nevojave.

3. Plani operativ

3.1. Potenciali për rritjen e biznesit.

Kompania për Menaxhimin e Deponive (KMD SH.A.) planifikon që të ketë rritje dhe zgjerim të biznesit me anë të riciklimit të mbeturinave sipas Legjislacionit në fuqi në Deponitë Sanitare në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Podujevë dhe ST Ferizaj .

Në vitet në vijim mund të ketë rritje të biznesit dhe të kompanisë me anë të Riciklimit.

Tabela 1. Rritja e tregut

Viti	Deponitë sanitare			Stacionet e transferimit
2015	PR	PZ	GJI	FE
2016	PR	PZ	GJI	FE
2017	PR	PZ	GJI	FE

3.2 Aktivitetet primare dhe sekondare të biznesit të Kompanisë

3.2.1 -Aktiviteti primar është pastrimi dhe evitimi i ujërave ndotëse, trajtimi i hedhurinave (mbeturinave) dhe veprimtari sanitare të ngjashme,

3.2.2-Aktivitetet sekondare - riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jo metalike etj.

Deri në fund të vitit 2016 mund të ketë ulje të sasisë së mbeturinave të deponuara në katër Deponitë Sanitare dhe Stacion Transferi. Kjo ulje mund të vije si rezultat i procesit të riciklimit në disa komuna. Në qoftë se KMDK fillon procesin e riciklimit brenda deponive mund të ketë ngritje të të hyrave nga ky proces.

Tabela . Hedhja e mbeturinave në tonelata

Deponia sanitare	Njësia	2013	2014	2015	2016
KRM Prishtinë	t	81,208	77,148	74,834	72,589
Privat Prishtinë	t	7,130	6,773	6,570	6,373
KRM PZ	t	47,536	44,998	43,648	42,339
Privat PZ	t	23,768	22,580	21,902	21,245
KRM Gjil	t	24,362	23,144	22,450	21,776
Privat Gjil	t	3,565	3,386	3,284	3,185
KRM Pod	t	7,625	6,815	6,610	6,412
Privat Pod	t		510	495	480
STF	t	11,884	10,824	10,500	10,185
STF Privat			546	529	513
Gjithsej	t	207,078	196,724	190,822	185,097

* në tabelën e mësipërme parashihet ulje e sasive të mbeturinave e cila mund të jetë si rezultat i procesit të riciklimit.

4. Plani i analizave financiare

Kompania për Menaxhimin e Deponive synon që në vitet e ardhshme (2014-2016) të krijoj mundësi që të filloj me aktivitete të reja (ndarja e mbeturinave, riciklimi) etj. të cilat do i sjellin përfitime Kompanisë dhe shoqërisë në Kosovë.

Gjatë viteve të ardhme planifikojmë riciklim të mbeturinave, ku në vitin 2015 parashihet 5% i mbeturinave të deponuara të riciklohen nëpër DS.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të lartë cekura do të rriten mundësitë për punësime të reja ku do ketë impakt në aspektin social.

Kompania synon që të mbulojë kostot operative më përjashtim të amortizimit, më të ardhura nga të hyrat vetanake (shih projeksionet financiare në Aneksin I)

Anex I

	Projeksioni i të hyrave në fund të vitit 2014 <i>Euro</i>	Pasqyra e të hyrave në fund të vitit 2013 <i>Euro</i>
Të ardhurat		
Të hyrat nga KRM-të	865,153	916,586
Të hyrat nga klientët privat	179,452	182,998
Të hyrat nga mbetjet shtazore	209,805	102,000
Të hyrat nga marrëveshjet me KRM-të	282,195	390,000
	<u>1,536,605</u>	<u>1,591,584</u>
Shpenzimet		
Pagat	504,189	429,108
Shujta	44,730	19,500
Mëditje,Udhëtimi dhe Reprerentacioni	24,000	20,000
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë	40,000	46,750
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtje të automjeteve	10,000	20,000
Shpenzimet për vajra dhe filtra	29,500	30,000
Shpenzimet për pjesë rezervë	35,000	80,000
Shpenzimet për derivate të naftës	240,000	275,000
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës	251,000	480,000
Shpenzimet e digjitalizimit në DS	58,000	
Blerje të makinerisë së rëndë	90,000	
Shërbimet e konsulencës dhe trajnimet	12,000	12,500
Shpenzimet administrative	99,500	85,000
Të tjera (të parapara)	50,000	43,000
Blerja e automjeteve	30,000	31,000
Amortizimi	842,173	842,173
Totali I Shpenzimeve	<u>2,360,092</u>	<u>2,414,031</u>
Humbjet në punë	<u>-823,903</u>	<u>-822,447</u>
Të hyrat financiare	-	-
Të ardhurat jo operative (burimet tjera)	600,000	610,000
Shpenzimet financiare	-	-
Humbja para tatimit në të hyra	<u>-223,903</u>	<u>-235,537</u>

4.1. Deklarata dhe analiza e të hyrave

Në periudhën 2014 - 2016 KMDK planifikon që të realizoj këto të hyra si në tabelën e mëposhtme.

Tabela . Të hyrat nga mbeturinat në (€)

Deponia sanitare	Njësia	2013	2014	2015	2016
KRM Prishtinë	t	431,215	409,656	397,369	385,448
Privat Prishtinë	t	37,860	35,965	34,887	33,841
KRM PZ	t	252,416	238,939	231,771	224,820
Privat PZ	t	126,208	119,900	116,300	112,811
KRM Gjil	t	129,362	122,895	119,210	115,630
Privat Gjil	t	18,930	17,980	17,438	16,912
KRM Pod	t	40,489	36,188	35,099	34,048
Privat Pod	t		2,708	2,628	2,549
STF	t	63,104	57,475	55,755	54,082
STF Privat			2,899	2,809	2,724
Gjithsej	t	1,099,584	1,044,605	1,013,265	982,865

Kompania do të ngarkojë, koston e deponimit të mbeturinave mbi kompanitë regjionale për grumbullim dhe transportim të mbeturinave dhe klientët tjerë privat. Pagesat do të realizohen nga klientët për kompaninë me qëllim që të mbulojmë koston e ofrimit të shërbimeve. Tarifa aktuale është më e ulët kur krahasohet me shpenzimet operative për ton.

KMDK synon të ngrit inkasimin përmes:

1. Marrjes së masave administrative (kufizimin e qasjes nëpër deponi) ,
2. Ofrimi i mundësive për të riprogramuar borxhet e grumbulluara,
3. Përmes inicimit të padive nëpër gjykatat kompetente më qëllim të përmbushjes së obligimeve të klientëve ndaj KMDK-së si dhe
4. Përmes mundësive tjera ligjore.

4.2. Analiza e shpenzimeve

KMDK planifikon shpenzimet gjatë periudhës 2014 -2016 të jenë sipas tabelës në vijim.

Tabela . Plani i shpenzimeve operative (€)

Shpenzimet Operative	Unit	2013	2014	2015	2016
Pagat	€	429,108	504,189	551,376	614,376
Shujta	€	19,500	44,730	49,200	55,200
Mëditje,Udhëtimi dhe Reprerentacioni	€	20,000	24,000	25,000	26,000
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë	€	46,750	40,000	60,000	70,000
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtje të automjeteve	€	20,000	10,000	15,000	15,000
Shpenzimet për vajra	€	30,000	29,500	30,000	30,000
Shpenzimet për pjesë rezervë	€	80,000	35,000	40,000	50,000
Shpenzimet për derivateve të naftës	€	275,000	240,000	250,000	260,000
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës	€	480,000	251,000	200,000	180,000
Shpenzimet e digjitalizimit në DS	€	-	58,000	-	-
Blerje të makinerisë së rëndë	€	-	90,000	-	100,000
Shërbimet e konsulencës dhe trajnimet	€	12,500	12,000	20,000	22,000
Shpenzimet administrative	€	85,000	99,500	63,000	66,000
Të tjera (të parapara)	€	43,000	50,000	60,000	60,000
Blerja e automjetit	€	31,000	30,000	38,000	20,000
Gjithsej	€	1,571,858	1,517,919	1,404,576	1,571,576

5. Plani i zhvillimit të Personelit

5.1 Struktura e Re Organizative

KMDK sipas nevojës për të kryer më me efikasitet punën dhe shërbimin do të punësoj personel shtesë.

Në vitin 2014 kemi planifikuar edhe 3 vende të reja pune (dy Zyrtar regional për koordinim në Operative dhe një IT). Arsyeja e shtimit të numrit të punonjësve (stafit) bëhet për faktin se duke ju referuar legjislacionit mjedisor në fuqi Përgjegjësit e deponive duhet të jenë me përgatitje universitare dhe më qëllim të finalizimit të Web faqes së kompanisë planifikojmë që të angazhojmë edhe një punëtor në pozicionin e IT-së.

Shih Organogramin në vijim :


5.2. Trajnimet e personelit.

Ekipi menaxhues do të identifikojë fushat ku planifikon të zhvilloj trajnime për avancim të metutjeshëm profesional.

Në këto trajnime do të përfshihen financat, prokurimi , administrata, operativa dhe sipas nevojës edhe stafi tjetër.

5.3. Politika e pagesës së personelit.

Stafi i KMDK-s do të kompensohet konform rregulloreve të brendshme të kompanisë dhe kontratave të punës.



Ky organogram është i hartuar sipas rregulloreve të Brendshme të Brendshme të KMDK, në këtë organogram janë të paraqitura të gjitha pozitat e parapara me Rregulloret të Brendshme të KMDK-së, mirëpo kemi ende disa pozita të paplotësuara të punës si: Zyrtar Ligjor, Asistente e Administratës, Inxhinier i Makinerisë.

6. Plani i investimeve

Plani i investimeve për periudhën 3 vjeçare është planifikuar si në vijim, ku përfshihen: investimet në infrastrukturë, furnizimet më makineri të rëndë, dezinfektim deratizimi dhe dezinfektim i deponive dhe përgatitja e infrastrukturës për riciklim të mbeturinave.

Këto investime planifikojmë që ti realizojmë nëse: do arrijmë inkasimin 100% dhe arrijmë ti mbledhim borxhet që kanë klientët tanë ndaj nesh dhe në rast se gjejmë donatorë nga jashtë dhe përkrahemi nga Aksionari.

6.1. Plani i investimeve për vitin 2014

ID dhe titulli i projektit:	P001: Furnizim më makineri të rëndë
Koha e përfundimit të procedurave:	Shkurt 2014
Vlera totale e llogaritur:	290.000 Euro (200.000 € F. I jashtëm , 90.000 € F. i Brendshëm)
Burimi i financimit:	Financim i kombinuar

Përshkrimi: Qe deponitë të funksionojnë dhe të kenë operim të mirëfilltë dhe të garantojnë siguri operuese dhe mos të ketë ndotje të ambientit është e domosdoshme të kemi makineri shtesë me sa vijon: dy buldozher 19 dhe 20 T (këta buldozher të shtyjnë mbeturinat të cilat deponohen në baza ditore).

ID dhe titulli i projektit:	P002: Rehabilitimi i Deponive Sanitare
Koha e përfundimit të procedurave:	Shkurt 2014
Vlera totale e llogaritur:	201.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i Brendshëm

Përshkrimi: Përmes këtij projekti , kompania synon rehabilitimin e Deponive Sanitare , rrëzimin e skarpateve në DS Prizren dhe Podujevë, shërbime të makinerisë nga O.E kur makineritë tona janë defekt, elektrifikimin në DS Podujevë dhe STF , trajtimin e mbeturinave të cila kanë mbetur ende pa u trajtuar si dhe synon plotësim të standardeve.

ID dhe titulli i projektit:	P003: Dezinfektimi,Dezinfektimi dhe Deratizimi i Deponive Sanitare në Kosovë
Koha e përfundimit të procedurave:	Maj 2014
Vlera totale e llogaritur:	100.000 Euro (50.000 € F. I jashtëm , 50.000 € F. i Brendshëm)
Burimi i financimit:	Financim i kombinuar

Përshkrimi: Dezinfektimi,dezinfektimi dhe deratizimi do të bëhet nëpër të gjitha DS regjionale. Qëllimi i realizimit të këtij projekti është në parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve infektive, dhe bartjes së sëmundjeve në mjediset tjera. Qëllimi tjetër i projektit ka të bëjë në eliminimin e brejtësve (minjve), të cilët i dëmtojnë makineritë tona dhe ndikojnë në bartjen e sëmundjeve tek punëtorët, dezinfektimi kundër gjarpinjve që paraqesin rrezik për punëtorët të cilët operojnë në deponi.

Hapat që duhen ndërmarrë janë këto deponi të deratizohen dhe dezinfektohen nga kompani të specializuara të lincësuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

ID dhe titulli i projektit:	P004: Projekti i digjitalizimit të Deponive Sanitare
Koha e përfundimit të procedurave:	Korrik 2014
Vlera totale e llogaritur:	58.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i brendshëm

Përshkrimi: Përmes funksionalizimit të sistemit kompjuterik, kompania synon pajisjen e të gjitha DS me softver-kompjuterë, duke digjitalizuar sistemin e të dhënave dhe komunikimit përbrenda vetë kompanisë me kompanitë dhe institucionet tjera relevante në Kosovë.

- Ngritjen e sigurisë në të gjitha DS, me qëllim të ruajtjes së aseteve brenda DS dhe uljes së rrezikshmërisë për ndotje të mjedisit (rreziku nga ndezja e zjarrit dhe rreziku nga dëmtimi i lagunave me ujërat e zeza);
- Vëzhgimi dhe monitorimi nga Qendra dhe vënia nën kontrollë e gjithë hapësirës së vend-deponimit të mbeturinave.

6.2. Projektet e synuara gjatë periudhës 2014-2016

ID dhe titulli i projektit:	P005: Ri- instalimi i sistemit të drenazheve për ujëra të bardha/zeza
Koha e përfundimit të procedurave:	Mars 2014
Vlera totale e llogaritur:	200.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i Jashtëm

Përshkrimi: Përmes këtij projekti, kompania synon rehabilitimin e drenazheve sidomos në DS- Prizren, Gjilan dhe Podujevë pasi një pjesë e këtyre drenazheve janë të dëmtuara ku vjen deri të përzierja ujërave të zeza me të bardha, rritet sasia e ujërave të zeza në lagunë kjo ka ndikuar që kompania të ballafaqohet me probleme të ujërave të zeza gjatë kushteve të vështira atmosferike.

Hapat të cilët duhen ndërmarrë,

Hapat që duhen ndërmarrë janë gypat drenazhues ekzistues të zëvendësohen me të rinjë të ndahen sektorët mirë të izolohen me argjilë të padepërtueshme nga uji në mënyrë që ujërat e zeza të mos bien në kontakt me ujërat e bardha, ujërat e zeza derdhen në lagunë ndërsa ujërat e bardha në kanale atmosferike dhe derdhen në recipient (lumë).

ID dhe titulli i projektit:	P006: Trajtimi i ujit në liqe me anë të rezervarit të hirit
Koha e përfundimit të procedurave:	Qershor 2014
Vlera totale e llogaritur:	460.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i jashtëm

Përshkrimi: duke pasur parasysh madhësinë e deponise sanitare me karakter regjional të cilët i menaxhon KMDK dhe kapacitetet e vëllimit të ujërave të grumbulluara është i nevojshëm investimi i projektit të trajtimit të ujërave në liqe me anë të rezervarëve të hirit në Prishtinë DS Mirash. Sasia totale e ujit të ndotur në zonën e liqenit që duhet të trajtohet është përafërsisht 400.000m³. Trajtimi i ujërave bëhet përmes rezervarit të hirit i cili gjendet në pronësi të KEK-ut ku përmes këtij rezervari të hirit i cili do të shërbejë si rezervar oksidimi për largimin e BOD nga uji. Ky projekt do të mundësojë përmisimin e cilësisë së ujërave në deponinë e Prishtinës duke evituar rrezikun nga përmbytja e deponisë, evitimin e ndotjes në mjedis dhe sigurinë e personelit punues dhe makinerinë e KMDK-së.

Hapat që duhet ndërmarrë,

- Së pari të trajtohen këto ujëra qoftë përmes rezervuarve të hirit apo përmes impianteve të pastrimit të ujërave të zeza, kthimin e qëndrueshmërisë së DS, restaurimin e lagunës si dhe gypave drenazhues të cilët përcjellin ujërat e zeza nga DS në lagunë, aftësimin e pompave ricikluese.

ID dhe titulli i projektit: P007: Përgatitja e infrastrukturës dhe pajisjeve për riciklim të mbeturinave.
 Koha e përfundimit te procedurave: Qershor 2014
 Vlera totale e llogaritur: 300.000 Euro

Burimi i financimit: Financim i jashtëm

Përshkrimi: Përmes këtij projekti kompania synon ngritjen e qëndrueshmërisë financiare , zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të deponuara në DS , rritjen e jetëgjatësisë së tyre , mbrojtje të mjedisit duke synuar politikat e Bashkimit Evropian për menaxhim të mbeturinave.

Në këtë projekt përfshihet , ndërtimi i pllakos për riciklim brenda trupit të DS , blerja e pajisjeve të cilat përdoren për riciklimin e mbeturinave , rregullimin e infrastrukturës me objekte përcjellëse etj.

ID dhe titulli i projektit: P008: Projekt propozim për monitorimin e gjendjes së mjedisit në Deponitë Sanitare

Koha e përfundimit te procedurave: Gusht 2014
 Vlera totale e llogaritur: 200.000 Euro

Burimi i financimit: Financim i jashtëm

Përshkrimi : Programi i monitorimit ju ofron operatorit informata për të vlerësuar efektin e deponisë në mjedisin rrethues dhe ofron ndihmë dhe siguri që deponia është duke operuar dhe kontrolluar në bazë të standardeve gjenerale për DS dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës. Kështu programi i monitorimit sjell ose lejon njohjen e hershme të efekteve negative mjedisore dhe kështu lehtëson rrugën për të marrë veprime korrigjuese të shpejta.

Për shkak të problemeve financiare, dhe inkasimit të ulët kompania nuk ka arrite të hartoi dhe implementoi programin e monitorimit.

6.3 Plani i investimeve për vitin 2015

ID dhe titulli i projektit: P001: Ndryshimin e metodës së trajtimit të ujërave të zeza në laguna nëpër DS Gjilan dhe Prizren
 Koha e llogaritur përfundimit: Korrik 2015
 Vlera totale e llogaritur: 300,000 Euro
 Burimi i financimit: Financim i jashtëm

Përshkrimi: Duke marrë parasysh që sistemi ekzistues i cili trajton ujërat e zeza përmes spërkatjes dhe avullimit nuk është i qëndrueshëm sidomos gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit kur ka reshje të mëdha atmosferike, kompania është ballafaquar me probleme të mëdha të trajtimit të ujërave të zeza prej fillimit të funksionimit të DS . Përmes këtij projekti kompania synon të gjejë mënyra të qëndrueshme , që këto ujëra të zeza të cilat grumbullohen në DS ti trajtoj brenda normave të shkarkimit me sistem të hapur jashtë trupit DS (impiante të vogla , biofiltra me kontinierë etj).

ID dhe titulli i projektit: P002: Projekti i instalimit të sistemit të lirimit të Gazit në DS

Koha e përfundimit te procedurave: Gusht 2015
 Vlera totale e llogaritur: 300.000 Euro
 Burimi i financimit: Financim i jashtëm

Përshkrimi : Qëllimi i këtij projekti është instalimi i një sistemi menaxhues të gazit me efekt pozitiv në mjedis. KMDK, në varësi të ndihmës financiare në fillim do të fokusohet vetëm në hallkat e para të zingjirit të procesit të menaxhimit të gazit. Përmes këtij projekti do të arrihet :

- Minimizimi i emetimeve të metanit dhe dioksidit të karbonit nga trupi i deponisë, gazra serë të fuqishme që janë një prej shkaktarëve kryesorë të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike
- Ppërmirësimi i cilesisë së ajrit lokal dhe rajonal duke ulur emetimin e metanit dhe kompozimet tjera organike të paqëndrueshme që janë të lidhura zakonisht me emetimin e gazit të deponisë.
- Ppërdorimi i gazit të deponisë si një burim të energjisë së ripërtitshme dhe të zëvendësojë konsumin e karburanteve fosile konvencionale të tjera, të cilat do të zvogëlojnë emetimin e dioksidit të karbonit.
- Parandalimi i zjarreve që është dukuri që shkakton shfaqjen e zjarreve në DS

Mungesa e gypave gazifikues për ajrosje në trupin e Deponive Sanitare, sipas standardeve gjenerale, mund të shkaktohen zjarre dhe shpërthime me pasoja shumë të rënda nga plasja e gazrave si metani, i cili prodhohet gjatë kalbjes së mbeturinave në kontakt me lagështinë mund të vijë deri të eksplodimi apo ndezja e zjarreve të furishme.

Hapat që duhet ndërmarr në instalimin e sistemit të ajrosjes, si dhe mbeturinat e ekspozuara të kompaktohen dhe të mbulohen mirë.

ID dhe titulli i projektit:	P003: Projekt propozim për monitorimin e gjendjes së mjedisit në Deponitë Sanitare
Koha e përfundimit të procedurave:	Gusht 2015
Vlera totale e llogaritur:	150.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i jashtëm

Përshkrimi : Programi i monitorimit ju ofron operatorit informata për të vlerësuar efektin e deponisë në mjedisin rrethues dhe ofron ndihmë dhe siguri që deponia është duke operuar dhe kontrolluar në bazë të standardeve gjenerale për DS dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës. Kështu programi i monitorimit sjell ose lejon njohjen e hershme të efekteve negative mjedisore dhe kështu lehtëson rrugën për të marrë veprime korrigjuese të shpejta.

Për shkak të problemeve financiare, dhe inkasimit të ulët kompania nuk ka arrite të hartoi dhe implementoi programin e monitorimit.

6.4 Plani i investimeve 2016

ID dhe titulli i projektit:	P001: Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi i Deponive Sanitare në Kosovë
Koha e llogaritur e përfundimit:	Maj 2016
Vlera totale e llogaritur:	150.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i jashtëm

Përshkrimi: Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi do të bëhet nëpër të gjitha DS regjionale. Qëllimi i realizimit të këtij projekti është në parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve infektive, dhe bartjes së sëmundjeve në mjediset tjera. Qëllimi tjetër i projektit ka të bëjë në eliminimin e brejtësve (minjve), të

cilët i dëmtojnë makineritë tona dhe ndikojnë në bartjen e sëmundjeve tek punëtorët, dezinfektimi kundër gjarprinjëve që paraqesin rrezik për punëtorët të cilët operojnë në deponi.

ID dhe titulli i projektit:	P002:Furnizim me makineri të rëndë
Koha e llogaritur e përfundimit:	300.000 Euro (200.000 € F. I jashtëm , 100.000 € F. i Brendshëm)
Burimi i financimit:	Financim i kombinuar

Përshkrimi: Që deponitë të funksionojnë dhe të kenë operim të mirëfilltë dhe të garantojnë siguri operuese dhe mos ndotjen e mjedisit është e domosdoshme të kemi makineri shtesë me sa vijon: Një buldozher 19 dhe 20T (këta buldozherë të shtyjnë mbeturinat të cilat deponohen në baza ditore).

ID dhe titulli i projektit:	P003:Përgatitja e infrastrukturë dhe pajisjeve për riciklim të mbeturinave.
Koha e llogaritur e përfundimit:	Qershor 2016
Vlera totale e llogaritur:	450.000 Euro
Burimi i financimit:	Financim i jashtëm

Përshkrimi: Përmes këtij projekti kompania synon ngritjen e qëndrueshmërisë financiare , zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të deponuara në DS , rritjen e jetëgjatësisë së tyre , mbrojtje të mjedisit duke synuar politikat e Bashkimit Evropian për menaxhim të mbeturinave.

Në këtë projekt përfshihet , ndërtimi i pllakos për riciklim brenda trupit të DS , blerja e pajisjeve të cilat përdoren për riciklimin e mbeturinave , rregullimin e infrastrukturës me objekte përcjellëse etj.

7. Sfidat dhe Rreziqet nga Plani i biznesit..

Sfidat e përmbushjes së Planit të Biznesit

- Rritja e inkasimit,
- Ngritja e Tarifës
- Mbledhja e borxheve
- Kthimi i Borxheve
- Operimi nëpër DS
- Mirëmbajtja e Makinerisë
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe zvogëlimi i ndotjes
- Ndarja e mbeturinave me qëllim të riciklimit.

Rreziqet e mos përmbushjes së Planit të Biznesit

- Mos trajtimi i ujërave të zeza sidomos në DS Mirash,
- Mos përmbyllja e proceseve gjyqësore gjatë periudhës 2014 - 2016.
- Amortizimi i aseteve ,
- Shfaqja e zjarreve, eksplozimi i deponive nga gazrat e grumbulluara, vërshimeve dhe fatkeqësive tjera.
- Fillimi i procesit të ndarjes së mbeturinës nëpër Komuna, çka mund të rezultojë në uljen e sasisë së mbeturinave nëpër DS dhe
- Mos ngritja e tarifës e cila nuk paraqet koston reale të shpenzimeve operative për ton mbeturinë.